



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Date: 29.09.2016

576/2016
10.11.2016

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

QENDRIMI PARIMOR

1. Ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rigjykim, nuk është e lejuar.
2. Me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila është paraqitur në dëm të akuzuarit, vendimi i formës së prerë, nuk mund të ndryshohet në dëm të pandehurit, por vetëm konstatohet shkelja ligjore në favor të tij.

A r s y e t i m

Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme, ka konstatuar se është krijuar një presedan në praktikën e kësaj Gjykate, për faktin se në dy raste, kolegji me shumicë gjyqtarësh nga komponenta e EULEX-it, kanë marr vendim, i cili dallon nga vendimet që në raste të tilla i marrin kolegjet me gjyqtarë vendorë dhe me këtë krijon trajtim divergjent- të ndryshëm, të të akuzuarve dhe vë në pozitë të pabarabartë në një proces penal.

1. Rasti parë

Ka të bëjë me një çështje penale, ku Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësve të të akuzuarve ka miratuar ankesat, ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim. Kundër këtij aktvendimi Prokurori i Prokurorisë Speciale (EULEX-it) ka paraqitur “Ankesë” dhe në vend që ankesa të hedhet si e palejuar, kolegji i kësaj Gjykate me shumicë gjyqtarësh nga EULEX-i, ka miratuar ankesën dhe ka “anuluar “aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen ia ka kthyer po kësaj Gjykate në rigjykim. Ky presedan prej themelimit të Gjykatës Supreme, për herë të parë ka ndodhur edhe ankesa dhe vendim të tillë nuk ka pas as nga prokurorët, as nga gjyqtarët e UNMIKU-ut dhe të EULEX- it, gjerë në këtë moment.

2. Rasti i dytë.

Kolegji i gjyqtarëve të EULEX-it, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë që prokurori shtetëror kishte paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin në një pjesë aktakuzës ndaj të pandehurve ishte hedhur për shkak se gjykata kishte konsideruar se është bërë pas afatit të parashkruar me ligj, kishte aprovuar kërkesën, kishte ndryshuar aktvendimin dhe aktakuzën e kishte konsideruar të afatshme.

Dy vendime diametralisht të kundërta, nga e njëjta gjykatë për çështje të njëjtë

Derisa ankesat e tilla nga gjyqtarët vendorë, por edhe nga ata ndërkombëtarë (*deri me këtë vendim*) hedhen si të palejueshme, kolegji referues e ka konsideruar të lejueshme dhe ka krijuar një presedan i cili krijon pasiguri juridike edhe pabarazi të palëve para ligjit.

Baza ligjore (legale)

Ligji nuk lejon ankimime të dyfishta për çështje të njëjtë, përpos rasteve kur një gjë e tillë është paraparë shprehimisht me ligj, ngase do krijohet një rreth vicioz dhe çështja asesi nuk do përfundonte, po do sillej Gjykatë e Apelit - Gjykatë Supreme.

Sipas nenit 407 të KPPK-së, vetëm kundër aktgjykimit gjykues të Gjykatës së Apelit i akuzuari dhe prokurori shtetëror në favor të akuzuarit (*jo në dëm të tij*), mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të Gjykatës Themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin, ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm, por në asnjë mënyrë ndaj aktvendimit me të cilin është anuluar aktgjykimin dhe çështja është kthyer në rigjykim, ngase në situata e tillë nuk kemi vendim. Duhet pritur vendimi i ri, ku palët ruajnë të drejtën që ndaj vendimit që merret në ri-procedurë të shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike.

Llojet e aktvendimeve që mund të ankimohen

Neni 408 i KPPK-së, është emërtuar "Llojet e aktvendimeve që mund të ankimohen", dhe sipas këtij neni, mund të ankimohen vetëm këto aktvendime: "*aktvendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe aktvendimet tjera të gjykatës themelore, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë*". Kjo është dispozitë bazë që rregullon lejueshmërinë e ankesës ndaj aktvendimit dhe këtu nuk thuhet se ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallë së dytë lejohet ankesa, por ndaj aktvendimit të gjykatës themelore.

2. Ndaj kujt paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë (Neni 432 i KPPK).

Së pari në rastin që po i referohem, *kërkesa për mbrojtjen të ligjshmërisë nuk është e lejuar*, ngase procedura nuk kishte përfunduar, por ishte në rrjedhë e sipër, meqë aktakuza në një pjesë ishte konsideruar e afatshme. Ligji lejon ushtrimin e këtij mjeti juridik të jashtëzakonshëm akoma pa përfunduar procedura me formë të parë, vetëm kur është në pyetje paraburgimi, neni 432 par.4. i cili shprehet: "*Pavarësisht nga dispozita e paragrafit 1. të këtij nenin, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formën të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit*".

Mirëpo nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur në dëm të pandehurit, ndërsa Gjykata Supreme vlerëson se kërkesa është e bazuar dhe se në rastin konkret është shkelur ligji në favor të pandehurit, vetëm konstatohet shkelja, pa u ndryshuar vendimi i formës së prerë (neni 438 par.2. të KPPK-së).

Me këto vendime të ndryshme nga kolegjet e ndryshme për çështje të njëjta, krijohet pabarazi tek qytetarët

Pabarazi për faktin se në rastin kur për çështjet vendosin gjyqtarët vendorë (ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit me të cilin është prishur aktgjykimi i shkallës së parë), ankesën tillë e hedhin të pa lejueshme dhe çështja rrjedh nga fillimi, kur vendosin ndërkombëtarët, këto ankesa i konsiderojnë të lejueshme, edhe mund të miratojnë ankesën, ta ndryshojnë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ta vërtetojnë aktgjykimin e shkallës së parë, d.m.th., te rasti i parë, të pandehurit i jepet mundësia që edhe njëherë në procedurë në shkallën e parë t'i paraqes të gjitha argumentet për vendim të favorshëm ndaj tij, ndërsa në rastin e dytë (kur vendos kolegji që ka këtë botëkuptim juridik) kjo mundësi nuk i jepet.

Për rastin e dytë (kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë), kur kolegjet vendore vlerësojnë, se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë që është paraqitur në dëm të pandehurit është e bazuar dhe është shkelur ligji në favor të tij (pandehurit), vetëm e konstatojnë shkeljen, pa e ndryshuar vendimin (pa e ndryshuar më pozitën penalo juridike të pandehurit), ndërsa kur vendosin ndërkombëtarët, mund ta ndryshojnë vendimin dhe ndaj të pandehurit në ri procedurë mund të merret një vendim i disfavorshëm për të, nga ai i mëparshmi.

Vendimet e tilla divergjente, krijojnë edhe pasiguri juridike tek qytetarët

Krijon pasiguri juridike, ngase për rastin e parë, përkundër faktit se ligji në raste të tilla nuk lejon dy ankesa për çështjen e njëjtë, me këtë vendim u jepet mundësia që prokurorët, pavarësisht ligjit, të paraqesin ankime edhe ndaj aktvendimeve të Gjykatës së Apelit, me të cilën është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë.

Për rastin e dytë, përkundër faktit se ligji nuk lejon që me rastin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në dëm të pandehurit, të ndryshohet vendimi i plotfuqishëm, me këto vendime krijohet mundësia që edhe në raste të tilla, vendimet të ndryshohen.

Nëse po u lejuaka ankesa kundër aktvendimit me të cilin është prishur aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rigjykim, pse prokurorët vendorë nuk po e shfrytëzuan këtë “të drejtë”, pastaj pse prokurorët ndërkombëtarë gjerë me këtë rast, nuk kanë ushtruar në raste të tilla ankesa, ndërsa bëhet fjalë për dispozita të njëjta ligjor të pandryshuara që gjashtë(6) dekada(*ngase janë standarde në të drejtën penale*).

Së dyti, nëse paska mundësi ligjore të prishet vendimi i formës së prerë me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të të pandehurit, pse atëherë në raste të tilla, prokurorët vendorë vetëm kërkojnë të konstatohet shkelja, e kështu kanë vepruar edhe ata ndërkombëtarë gjerë në këtë rast dhe kështu kanë vendosur edhe gjyqtarët ndërkombëtarë gjerë në rastin referues(*ngase norma në mënyrë eksplicite ndalon ndryshimin e vendimit të tillë*).

(Qëndrim parimor i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016)